



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 25 shtator 2017
Nr. ref.:RK 1126/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI25/17

Parashtrues

Bukurije Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës-Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës, GSK-KPA-A-221/14, të 3 gushtit 2016

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bukurije Gashi nga Suhareka (në tekstin e mëtejme: parashtruesja e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesja konteston Aktgjykimin [GSK-KPA-A-221/14] e Gjykatës Supreme të Kosovës-Kolegjit të Apelit të Agjencisë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të AKP-së), të 3 gushtit 2016, që i është dorëzuar asaj në një datë të paspecifikuar.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të AKP-së, me të cilin, sipas pretendimeve të parashtrueses, janë shkelur të drejtat e saj nga neni 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 3 mars 2017, parashtruesja dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Selvete Gërzhaliu-Krasniqi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 19 prill 2017, Gjykata njoftoi parashtruesen dhe Kolegjin e Apelit të AKP-së për regjistrimin e kërkesës.
8. Gjithashtu, Gjykata po të njëjtën ditë kërkoi nga parashtruesja që brenda afatit të caktuar të dorëzojë fletëkthesën, si dëshminë se kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar.
9. Parashtruesja nuk u përgjigj brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e Gjykatës.
10. Më 17 maj 2017, parashtruesja i dërgoi Gjykatës një letër me komente, në mesin e të cilave nuk ishte dëshmia për datën e dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar.
11. Më 17 maj 2017, Gjykata i dërgoi Kolegjit të Apelit të AKP-së një letër me kërkesë që brenda afatit të caktuar t'ia dorëzojë dëshminë se kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar parashtrueses së kërkesës.
12. Kolegji i Apelit të AKP-së nuk u përgjigj në kërkesën e Gjykatës.
13. Më 21 qershor 2017, Gjykata i dërgoi përsëri kërkesën Kolegjit të Apelit të AKP-së, në të cilën kërkoi nga ai që t'ia dorëzojë fletëkthesën, si dëshminë se kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar parashtrueses së kërkesës.

14. Kolegji i Apelit të AKP-së nuk dërgoi asnjë përgjigje as në këtë kërkesë të Gjykatës.
15. Më 6 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

16. Gjykata, në bazë të shkresave të lëndës në kërkesë, mund të vërejë se më 19 janar 2007, Komisioni për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (në tekstin e mëtejme: HPCC), nxori Vendimin HPCC/ REC/ 89/2007, me të cilin ia njohu të drejtën e posedimit të banesës e cila gjendet në lagjen "Fidanishte" në Suharekë personit të tretë Z. S.
17. Më 10 tetor 2007, parashtruesja paraqiti ankesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (të tekstin e mëtejme: AKP), me të cilën kërkoi posedimin e banesës në fjalë.
18. Më 13 mars 2014, Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK), nxori Aktgjykimin nr. KPCC/D/R/231/2014, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar, me arsyetim: "*Parashtruesi i kërkesës, në këtë rast pala ankuese nuk e ka humbur posedimin si rezultat i konfliktit 1998/99.*"
19. Më 23 maj 2014, parashtruesja paraqiti ankesë në Kolegjin e Apelit të AKP-së kundër Vendimit të KKPK-së, nr. KPCC/D/R/231/2014.
20. Më 3 gusht 2016, Kolegji i Apelit të AKP-së nxori Aktgjykimin [GSK-KPA-A-221/14] me të cilin e refuzoi ankesën e parashtrueses si të pabazuar, ndërsa Vendimin e KKPK-së, të 13 marsit 2014, e vërtetoi në tërësi. Në arsyetimin e aktgjykimit thuhet: "*Në shkresat e lëndës ka mjaft elemente që tregojnë se banesa e tillë nuk ishte në posedim të palës ankuese (parashtrueses) në momentin e ndodhjes së konfliktit*".

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesja në kërkesë pretendon: "*se HPD, respektivisht Agjencioni Kosovar i Pronave ka bërë shkelje të ligjit dhe të drejtës së saj në pronë*".
22. Parashtruesja kërkon nga Gjykata "*të anulojë Vendimin e Kolegjit të Apelit të AKP-së dhe të miratojë kërkesën e saj për shfrytëzimin e banesës në fjalë*".

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

25. Gjykata i referohet edhe nenit 49 të Ligjit, i cili përcakton:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej 4 (katër) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

26. Gjykata, më tej, merr parasysh rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

1) *“Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*

(...)

(c) kërkesa parashtrohet brenda 4 (katër) muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesi.”

27. Gjykata me shqyrtimin e kërkesës së parashtrueses vërtetoi se ajo konteston Aktgjykimin [GSK-KPA-A-221/14] e Kolegjit të Apelit të AKP-së, të 3 gushtit 2016. Lidhur me këtë, Gjykata më 19 prill 2017, i dërgoi parashtrueses një shkresë në të cilën kërkoi nga ajo të tregojë se kur i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar [GSK-KPA-A-221/14] të Kolegjit të Apelit të AKP-së, si dhe të dorëzojë dëshmi me të cilat do t'i justifikojë pretendimet e saj për datën e dorëzimit të aktgjykimit.

28. Gjykata, më tej, thekson se parashtruesja nuk i dorëzoi asnjë përgjigje Gjykatës brenda afatit të përcaktuar.

29. Më 17 maj 2017, parashtruesja i dërgoi Gjykatës një letër me komentet, mbi bazën e të cilave Gjykata nuk ka mundur të përfundojë se kur i është dorëzuar asaj aktgjykimi.

30. Për më tepër, Gjykata me qëllim të përcaktimit se kur aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtrueses, i dërgoi dy herë kërkesa për dokumentacion shtesë Kolegjit të Apelit të AKP-së, dhe atë më 17 maj 2017 dhe 21 qershor 2017.

31. Megjithatë, Gjykata dëshiron të theksojë se Kolegji i Apelit të AKP-së nuk ka dërguar përgjigje në asnjë kërkesë të Gjykatës.

32. Gjykata shton se edhe nën supozimin se aktgjykimi i kontestuar të Kolegjit të Apelit të AKP-së i është dorëzuar parashtrueses diku në periudhën ndërmjet 4 gushtit 2016 dhe 2 nëntorit 2016, kërkesa është jashtë afatit ligjor 4 (katër) mujor, sepse është paraqitur më 3 mars 2017.

33. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor 4 (katër) mujor, sipas nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar se rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme, dhe se vendimet e mëparshme nuk janë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar (shih, rastin *O'Loughlin dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 23274/04, GJEDNJ,

Aktvendimi i 25 gushtit 2005; shih, po ashtu, rastin nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).

34. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme për shqyrtim për shkak se është paraqitur jashtë afatit, siç është përcaktuar me nenin 113.7 të Kushtetutës, parashikuar me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar më tej me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (c) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 6 shtator 2017, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Altay Suroy



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Arta Rama-Hajrizi